

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA GRAMSH**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2239 Prot.

Gramsh, më 02/06/2026

**VENDIM**

Nr.38 datë 29/05/2026

**PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT**  
**"Për dhënien e titujve vendorë të nderit"**

**I. BAZA LIGJORE**

Ky udhëzues bazohet në:

- \*Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- \*Karta Europiane e Autonomisë Vendore;
- \*Ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar;
- \*Ligjin nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë";
- \*Ligjin nr.45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish/sigurimit të shtetit";
- \*VKM-së nr.861/2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e Komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë";
- \*Regulloren e Funksionimit të Këshillit Bashkiak Gramsh.

**II. QËLLIMI**

Qëllimi i këtij udhëzuesi është:

- \* të rregullojë procedurën për dhënien e titujve vendorë të nderit;
- \* të garantojë transparencë, meritokraci dhe vlerësim objektiv të kontributeve të dalluara në fusha të ndryshme;
- \*të ruaj vlerën dhe prestigjin e titujve vendorë të nderit.

**III. PARIME THEMELORE**

Dhënia e titujve vendorë të nderit mbështetet në këto parime:

- \* vlerësimi i meritave të veçanta dhe kontributit të dalluar;
- \* nderimi publik;
- \* pa shpërblim financiar;
- \* nuk është një e drejtë e kërkueshme nga individi.

**IV. SUBJEKTET PËRFITUESE**

Titujt vendorë të nderit u jepen:

- \* shtetasve shqiptarë ose të huaj
- \* për kontribute të dalluara në:
  - \* zhvillimin e komunitetit;
  - \* promovimin e interesave lokale, kombëtare apo ndërkombëtare;
- \* Nuk përfitojnë persona që kanë qenë bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit.

**V. LLOJET E TITUJVE VENDORË**

1. Titulli "Qytetar nderi" jepet për:

- \* kontribute të shquara në dobi të bashkisë;

- \* veprimtari të veçantë në interes të komunitetit;
  - \* **rastet specifike dhe në raport me numrin e popullsisë së njësisë vendore.**
- Jepet edhe ndaj personaliteteve të huaja gjatë vizitave zyrtare protokollare*

2. Tituj të veçantë vendorë nderi:

- \* maksimumi 2 tituj në vit;
- \* krijohen me vendim të këshillit bashkiak sipas legjislacionit në fuqi.

Vendimi duhet të përmbajë:

- \* arsyen e nderimit shoqëruar me motivacionin përkatës;
- \* dhënia e titullit vendor "Qytetar Nderi" që përbën titullin më të lartë vendor se përse nuk mund të jepet;
- \* emërtimin e titullit (i lidhur me një ngjarje/datë lokale).

## VI. E DREJTA E PROPOZIMIT

Propozimi bëhet nga:

- \* kryetari i Bashkisë;
- \* çdo anëtar/e e Këshillit Bashkiak;
- \* prefekti i qarkut.

Gjithashtu për legjitimimin e palëve propozuese:

- \* çdo individ/organizata/shoqata/institucion mund të paraqesë kërkesë drejt Kryetarit të Bashkisë, anëtarëve të Këshillit Bashkiak dhe Prefektit për legjitimimin e kërkesës;
- \* **nuk lejohet vetëpropozimi.**

## VII. PARAQITJA E PROPOZIMIT

Afati : Minimumi 90 ditë para dhënies së titullit

Propozimi duhet të përmbajë:

- \* institucionin/organizata/shoqata propozues;
- \* bazën ligjore;
- \* të dhëna identifikuese të kandidatit;
- \* përshkrim të kontributeve të dalluara;
- \* meritave të veçanta publike;
- \* arsyetimin e detajuar;
- \* llojin e titullit vendor;
- \* dokumentacion provues;
- \* *vërtetim që:*
  - \* nuk është i dënuar, me vërtetim të Gjendjes Gjyqësore;
  - \* nuk është nën hetim, me vërtetim nga organet hetimore dhe gjyqësore;
  - \* vendimi nga Autoriteti për Informim mbi Dokumentat e ish-Sigurimit të Shtetit për çdo propozim të ardhur në Komisionin Këshillimor;
- \* nderime apo titujt e mëparshëm përbëjnë vlerë të shtuar.

## VIII. KOMISIONI KËSHILLIMOR

Ngritja : Jo më vonë se 60 ditë para dhënies së titullit vendor të nderit

Përbërja, 5 anëtarë:

- \* 3 nga Këshilli Bashkiak (autoritet vendimmarrës në komision);
- \* 2 personalitete të jashtme (autoritet konsultativ në komision).

Detyrat: \* verifikimi formal paraprak;  
\* verifikon propozimin/propozimet nga aspekti material dhe lëndor;  
\* kërkon informacion shtesë në funksion të shqyrtimit;  
\* vlerëson përputhshmërinë e kritereve sipas legjislacionit në fuqi;  
\* harton raport përfundimtar drejtuar Këshillit Bashkiak.

## IX. SHQYRTIMI I PROPOZIMIT

1. Verifikimi paraprak (5 ditë), Kontrollohet:

- \* ligjshmëria e propozimit;
- \* afati procedural i shqyrtimit;
- \* dokumentacioni dhe materialet shoqërues.

Vendimet:

- \* vazhdim i shqyrtimit në themel i propozimit/propozimeve;
- \* kërkesë për plotësim dosje (10 ditë);
- \* refuzim me arsytet përkatëse, dhe pasqyrim në raportin përfundimtar.

2. Shqyrtimi i plotë (30 ditë), Komisioni:

- \* analizon dhe shqyrton të gjitha provat shkresore të administruar;
- \* kërkon informacion shtesë nëse i shërben propozimit/propozimeve;
- \* vlerëson reputacionin publik të propozuarit/propozuarve.

*Procesi mund të shtyhet në raste të veçanta që ndikojnë në reputacionin e aktit të ngrimit në opinionit publik.*

## X. MENDIMI I KOMISIONIT

Komisioni Këshillimor jep:

- \* rekomandim për miratim sipas raportit vetëm për rastet e që propozohet dhënia e titullit vendor të nderit;
- \*  arsyetim të argumentuar për refuzim të kandidatit/kandidatëve si pjesë përbërëse e raporti, vetëm për vënien në dijeni të organit titulldhënës.

## XI. VENDIMMARRJA

- \* merret nga Këshilli Bashkiak me vendim zyrtar;
- \* dhënia e titullit vendor të nderit bëhet si rregull vetëm mbi bazë të raportit të komisionit këshillimor, përjashtim përbëjnë rastet e veçanta kur Këshilli Bashkiak mund ta vendosë ta jap drejtpërsëdrejti, sipas kuorumit të kërkuar në mbledhje;

\*në rast refuzimi i njëjti kandidat nuk mund të propozohet për 2 vjet.

## XII. HEQJA E TITULLIT

Titulli hiqet kur:

- \* personi dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- \* shpallet "person i padëshiruar" nga autoritetet ligjzbatuese vendase apo të huaja;
- \* vendos organi që e ka dhënë titullin vendor të nderit kryesisht apo me kërkesë por në çdo rast sipas parimeve të ligjshmërisë dhe të sigurisë juridike.

## PËRFUNDIM

Dhënia e titujve vendorë të nderit:

- \* është një proces formal dhe i rregulluar ligjërisht;
- \* kërkon dokumentim të plotë dhe verifikim të hollësishëm;
- \* synon vlerësimin real të kontributeve të dalluara në komunitet;
- \* në çdo rast dorëzimi i titullit vendor të nderit jepet me ceremoni zyrtare e organizuar nga autoritetet vendore.

## DISPOZITA KALIMTARE

Ky Udhëzues është i zbatueshëm, në rastet si:

- për çdo propozim/propozime që i drejtohen Komisionit Këshillimor pasi ky Udhëzues ka marrë autoritet nga Këshilli Bashkiak e në vijim;
- për çdo ndryshim që ka të bëjë me legjislacionin e mësipërm automatikisht ato bëhen të zbatueshme edhe pse nuk janë parashikuar sipas këtij Udhëzuesi;
- në çdo rast paqartësie apo paplotësie prevalon Ligji nr.139/2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar;
- çdo Udhëzues i mëparshëm që ka të bëjë me titujt vendorë të nderit shfuqizohet;
- ngarkohet për zbatimin e këtij Udhëzuesi, kryesia e këshillit bashkiak, komisioni këshillimor, sekretari i këshillit bashkiak;
- ky Udhëzues hyn në fuqi së bashku me Aneksin nr.1 si pjesë përbërëse e tij, vetëm pasi ka marrë aprovimin e Këshillit Bashkiak.


**Grupi i punës:**

- z.Fatbardh Çekrezi (përfaqësues i Këshillit Bashkiak)
- z.Edison Shahini (përfaqësues i Bashkisë)

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2026

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

Xhulia GJINI



**Kryetari i Këshillit Bashkiak**

Enis ZANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Gramsh, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2026

**Aneksi numër 1**

Tabela e pikëzimit për titullin vendor “Qytetar Nderi” - Totali maksimal: 100 pikë

Nr.	Kategoria e vlerësimit	Përshkrimi	Pikë max	Pikë kandidati
1	Niveli i arsimit dhe formimit akademik	Arsim i lartë, tituj/grada shkencorë, specializime të rëndësishme	10	
2	Kontributi profesional	Arritje të spikatura në profesion (shkencë, art, sport, administratë, biznes etj.)	15	
3	Impakti në komunitetin lokal	Ndikimi konkret në zhvillimin e bashkisë (punësim, projekte, shërbime)	20	
4	Promovimi i bashkisë / vendit	Rritja e imazhit të bashkisë në nivel kombëtar/ndërkombëtar	15	
5	Vlerësime dhe çmime	Dekorata, tituj, çmime të mëparshme	10	
6	Iniciativa dhe inovacioni	Projekte të reja, ide inovative me ndikim	10	
7	Integriteti dhe figura morale	Reputacion i pastër, etikë e lartë, pa probleme ligjore	5	
8	Kontribut vullnetar	Angazhime sociale, bamirësi, ndihmë për komunitetin	5	
9	Imazhi i lartë publik	Gëzon mbështetje të gjërë në komunitet	5	
10	Aktivitet social i dokumentuar	Pasqyrimi aktivitetit nëpërmjet: librave, revistave, televizionit, apo gazetave	5	

**Pragu i rekomanduar për fitimin e titullit:**

- Minimumi: 70 pikë → Kandidati konsiderohet i kualifikuar
- 80+ pikë → Kandidat shumë i fortë (prioritet i lartë)
- 90+ pikë → Figurë e një profili të lartë publik (rast i rrallë)

**Disa rregulla shtesë (të rëndësishme):**

- Kandidati duhet të marrë minimumi 50% të pikëve në kategorinë “Impakti në komunitet” (pra të paktën 12.5 nga 25), për të shmangur figura vetëm “simbolike”.
- Nëse ka probleme me integritetin (p.sh. çështje ligjore), kandidati skualifikohet automatikisht, pavarësisht pikëve.
- Komisioni mund të japë +5 pikë bonus për raste të jashtëzakonshme (p.sh. heroizëm, kontribute historike).